



REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUČITRAN

02 Nr. / Br 1163/23

Nr. i lq. / Br. st _____

Data: / Datum 10.10.2023

VUSHTRRI - VUČITRAN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, dhe nenin 22 të Rregullores (KKV) nr. 02/2023 për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës të Veprimtarive Afariste - Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë 01Nr. 48/23 datë 23.02.2023, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. Shfuqizohet vendimi 02Nr.943/23 datë 19.07.2023 me të cilin është zgjatë përkohësisht orari i punës, nga ora 22:00 në ora 23:00 i të gjitha veprimtaritë afariste – bizneseve në Komunën e Vushtrrisë.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi zbatohet Rregullorja (KKV) nr. 02/2023 për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës të Veprimtarive Afariste - Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë 01Nr. 48/23 datë 23.02.2023.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Ferit Idrizi

Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Inspektime,
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRIN
02 Nr./ Br. 1185/23
Nr. i fq./ Br. sf _____
Data: / Datum 16.10.2023
VUSHTRRI - VUÇITRIN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Ligjit Nr. 04/L-061 për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e Drejta Banesore i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-247 dhe Ligjin e ndryshuar dhe plotësuar Nr.08/L-011, si dhe Vendimin e Ministrit të Ministrisë për Mjedis Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë Nr. 262 të datës 12.10.2023 prot. Nr. 5975/23, dt. 12.10.2023, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, si dhe me kërkesë të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës – Departamenti i Planifikimit Hapësinor Ndërtimit dhe Banimit, Divizioni i Banimit datë 12.10.2023, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për shqyrtim të kërkesave për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore, në këtë përbërje:
 - 1.1 **Ismet Gashi**, Zyra Ligjore - kryesues i komisionit
 - 1.2 **Egzon Haradinaj**, Drejtorja për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar
 - 1.3 **Fadil Selimi**, Drejtorja për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë, anëtar
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të shqyrtoj kërkesat e bartësve të së drejtës banesore në Komunën e Vushtrrisë për të cilat dhënës i banesave janë institucionet publike komunale si dhe për banesat për të cilat është vërtetuar se shitësi i tyre është i panjohur, konform dispozitave ligjore me të cilat është e rregulluar kjo çështje si dhe bazuar në Vendimin e Ministrit të Ministrisë për Mjedis Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë Nr. 262 të datës 12.10.2023 prot. Nr. 5975/23, dt. 12.10.2023,
3. Kryesuesi i Komisionit ka për obligim që të raportoj me kohë në MMPHI - DPHNB, Divizionin e Banimit mbi realizimin e procesit të shitblerjes së banesave për të cilat ekziston e drejta banesore duke marrë parasysh që Vendimi i Ministrit ka afat kohorë.
4. Komisioni ka mandat edhe në rast të vazhdimit të afatit të përcaktuar nga MMPH, me vendimin nr. 262 të datës 12.10.2023 për paraqitjen e kërkesave për blerjen e banesave nga bartësit e të drejtës banesore.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohen vendimet 02nr.1097/22 datë 31.08.2022 dhe vendimi 02nr. 605/23 datë 22.05.2023.
6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit të Sekretarisë.





| | |
|--|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO | |
| KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN | |
| 02 Nr. / Br | 1195/23 |
| Nr. i fq. / Br. st | |
| Data: / Datum | 17.10.2023 |
| VUSHTRRI - VUÇITRN | |



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar në Vaxjo, Suedi nga data 05 deri 10 nëntor 2023, i zyrtareve të të komunës të shënuar si në vijim:
 - 1.1 znj. **Hava Mlinaku**, Drejtore për Administratë
 - 1.2 z. **Dardan Abazi**, Drejtor për Arsime
 - 1.3 znj. **Fortuna Krasniqi**, Drejtore për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
 - 1.4 znj. **Medina Bunjaku**, Drejtore për Kulturë Rini dhe Sport
 - 1.5 z. **Bekim Selmani**, Drejtoria për Administratë – sektori i gjendjes civile
 - 1.6 z. **Ekrem Miftari**, DKRS, Arkivi i qytetit
2. Shpenzimet e udhëtimit zyrtar për ditët e cekura në pikën 1 të këtij vendimi të mbulohen konform legjislacionit në fuqi.
3. Ftesa dhe agjenda janë të bashkëngjitura në shtojcë të këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të sekretarisë



REPubLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 1196/23

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 18.10.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, si dhe në kërkesën e Drejtorisë për Administratë nr. 50550/23 dt. 18.10.2022, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet ndarja e mjeteve financiare në shumë prej 120.00 € (njëqind e njëzet euro) nga buxheti i komunës, me rastin e organizimit të aktivitetit "Dita Ndërkombëtare për Personat me Mundësi të Barabarta" mbajtur më 16 tetor 2023 në Vushtrri.
2. Mjetet financiare në shumën e cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të paguhen nga subvencionet dhe transferet të Zyrës së Kryetarit si vijon:
 - 2.1 Për persona me aftësi të kufizuara, pjesëmarrës të këtij organizimi - 100.00 € (njëqind euro) prej të cilave për secilin pjesëmarrës (person me aftësi të kufizuar) nga 20.00 € (njëzet euro),
 - 2.2 Shpenzime për një koktej rasti, 20.00 € (njëzet euro).
3. Pagesa e mjeteve në shumë totale prej 120.00 € të transferohet në llogari bankare të Shoqatës "Handikos" dega në Vushtrri, e cila obligohet që 5 pjesëmarrëseve në këtë organizim të ua jap në cash nga 20.00 euro në emër të pjesëmarrjes me rastin e shënimit të kësaj dite.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës, ndërsa monitorimin e zbatimit në plotëni të këtij vendimi do t'a bëjë zyrtarja e komunës për barazi gjinore dhe të drejtat e njeriut znj. Remzije Zekolli, e cila do të ofroj raport me shkrim në zyrën e kryetarit të komunës.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë për Administratë
- Znj. Remzije Zekolli
- Arkivit të Sekretarisë.



| | |
|--|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO | |
| KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN | |
| 02 Nr. / Br | 1197/23 |
| Nr. i fq. / Br. st | |
| Data: / Datum | 18.10.2023 |
| VUSHTRRI - VUÇITRN | |



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe nenin 43 paragrafi 14 dhe 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PËR FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për caktimin e normave tatimore të tatimit në pronë të paluajtshme për vitin 2024, në këtë përbërje:
 - 1.1 Qemajl Hasani, Drejtorja për Buxhet dhe Financa, kryesues i komisionit
 - 1.2 Abit Abiti, ZKF, anëtar
 - 1.3 Besim Demiraj, Drejtorja për Buxhet dhe Financa, anëtar
 - 1.4 Nexhmedin Peci, Drejtorja për Buxhet dhe Financa, anëtar
 - 1.5 Bujar Klinaku, Sekretaria e Kuvendit, anëtar
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të përgatis propozimin për caktimin e normave tatimore për tatimin në pronë të pronës së paluajtshme në Komunën e Vushtrrisë për vitin 2024 duke i harmonizuar me çmimet e tanishme të tregut. Komisioni, pas përfundimit të punës, draftin e propozuar, përmes Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa do t'a procedoj për shqyrtim dhe aprovim në mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendin e Komunës.
3. Komisioni duhet të filloj me punë menjëherë.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Perfit Idrizi

Kryetari i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit të Sekretarisë.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRN

02 Nr./ Br 1201/23

Nr. i fq./ Br. st _____

Data/ Datum 19.10.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, me 28/04, qershor 2008), nenit 43 paragrafi 1 pika 14 dhe nenit 44 paragrafi 1 i Statutit të Komunës, si dhe propozimit të Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural dt. 18.10.2023, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M P E R F O R M I M T Ë K O M I S I O N I T

- 1 Formohet komisioni për shqyrtim të kërkesave – aplikacioneve për subvencionim të ujitjes së tokave bujqësore në këtë përbërje:
 - 1.1 **Fatmir Feka**, kryesues i komisionit,
 - 1.2 **Ragbete Krasniqi**, anëtare,
 - 1.3 **Rabije Zahiti**, anëtare.
- 2 Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të shqyrtoj, aplikacionet për subvencionim të ujitjes së tokave bujqësore në vitin 2023 bazuar në marrëveshjen e nënshkruar në mes të NH “Ibër Lepenc” për realizimin e projektit për ujitjen e kulturave bujqësore në Komunën Vushtrrisë 02Nr. 614/23 datë 24.05.2023.
- 3 Mandati i komisionit përfundon me përfundimin e implementimit të kësaj marrëveshje.
- 4 Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Ferit Idrizi

Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit për EBPZHR
- Anëtarëve të komisionit dhe
- Arkivit të Sekretarisë

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPËSTINA VUÇITRË

02 Nr. / Br 1202/23

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 19.10.2023

VUSHTRRI - VUÇITRË



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari



Në bazë të nenit 13 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, me 28/04, qershor 2008), nenit 43 paragrafi 1 pika 14 dhe nenit 44 paragrafi 1 i Statutit të Komunës, si dhe propozimit të Drejtorisë për Ekonomi Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural dt. 18.10.2023, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M
PER FORMIM TË KOMISIONIT

1. Formohet komisioni për shqyrtim të kërkesave – aplikacioneve për subvencionim të deleve, dhive, buallicave dhe bletëve, në këtë përbërje:
1.1 Tefik Maloku, kryesues i komisionit,
1.2 Rabije Zahiti, anëtare
1.3 Ragbete Krasniqi, anëtare
2. Komisioni në përbërje të cekur si në pikën paraprake të këtij vendimi do të shqyrtoj, vlerësoj dhe përzgjedhë përfituesit më meritore bazuar në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në thirrjen publike. Komisioni për punën e tij do të mbaj procesverbal.
3. Mandati i komisionit përfundon me përfundimin e realizimit të këtij projekti.
4. Komuna, brenda afatit të caktuar ligjorë do të lidhë kontratë me përfituesin e subvencionit.
5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit për EBPZHR
- Anëtarëve të komisionit dhe
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br. 1220/23

Nr. i fq. / Br. st. _____

Data: / Datum 23.10.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i komunës jep këtë:

URDHËRESË

1. Urdhëroj Drejtorët e Drejtorive të cilët janë bartës të realizimit të projekteve për asfaltim të rrugëve përkatësisht shtruarjes me kubëza të rrugëve, trotuareve apo sipërfaqeve tjera që punët në terren të fillojnë të ekzekutohen vetëm nëse prona është në pronësi të komunës. Në asnjë rast të mos bëhet asfaltimi apo ndërtimi me kubëza nëse prona në të cilën duhet të realizohet projekti, është në pronësi private.
2. Njësia buxhetore (Drejtoria) që ka planifikuar realizimin e projektit duhet paraprakisht të ndërmerr masa në bashkëpunim me Drejtorinë për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë për vërtetim të pronësisë.
3. Në rast të mospërfilljes së kësaj urdhërese do të merren masa ligjore ndaj drejtorëve përgjegjës.
4. Urdhëresa hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Urdhëresai iu dërgohet:

- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Drejtorisë për Shërbime Publike,
- Arkivit të Sekretarisë



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 1239/23

Nr. i fq. / Br. st _____

Data: / Datum 24.10.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLICA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, si dhe në kërkesë të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa e mjeteve financiare në shumë prej 5,000.00 € (pesëmijë euro) nga buxheti i zyrës së Kryetarit të Komunës – subvencione dhe transfere në llogari të OJQ L'art Gallery, përfitues i mjeteve me vendim të komisionit vlerësues të DKRS sipas thirrjes publike për subvencionim të OJQ-ve për vitin 2023.
2. Pagesa e mjeteve financiare sipas pikës 1 të këtij vendimi të bëhet për shkak të mungesës së mjeteve në Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport, kategoria subvencione dhe transfere.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyra e Kryetarit të Komunës.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ferit Idrizi

Kryetari i Komunës



Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Arkivit të Sekretarisë.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

Nr. Nr. / Br. 1240/23

Nr. i sig. / Br. st.

Data: / Datum 25.10.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari



Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale, si dhe nenin 43 par. 14 dhe nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës me datën 26.10.2023 merr këtë:

**VENDIM
PËR FORMIM TË EKIPIT KOMUNAL**

1. Formohet ekipi komunal për vlerësimin kolegjial të shkollave të Arsimit të nivelit 0 parashkollor, Arsimit Fillor, Arsimit të mesëm të Ulët, Arsimit të mesëm të lartë në komunën e Vushtrrisë, që ka për qëllim zhvillimin, përparimin dhe ngritjen e kapaciteteve në procesin mësimor.
1. Në përbërje të ekipit caktohen:
 - 2.1 Enver Bajrami, zyrtar i DKA-së për Arsimin e Mesëm të ultë.
 - 2.2 Kadrije Meniqi, zyrtare e DKA-së, për Arsimin fillor dhe parafillor
 - 2.3 Edona Shotani, zyrtare e DKA-së, zyrtare e Arsimit për çështje psikologjike
 - 2.4 Visar Sadriu, drejtor i SHFMU "A.Z.Çajupi" Vushtrri
 - 2.5 Halil Parduzi, drejtor i SHMU-2 – Vushtrri
 - 2.6 Leonora Krasniqi, drejtoreshë e SHFMU "Enver Hadri" Smrekonicë
 - 2.7 Ferit Avdiu, drejtor i SHFMU "7 Marsi" Bukosh
 - 2.8 Besarta Krasniqi, drejtoreshë e SHFMU "Abdyl Frashëri" Druar
 - 2.9 Nysret Zhabari, koordinator i cilësisë në SHFMU "Enver Hadri" Smrekonicë
 - 2.10 Leunora Mani, mësime të gjuhës shqipe në SHFMU "7 Marsi" Bukosh
 - 2.11 Selver Bajgora, pedagog në SHMU-2- Vushtrri
 - 2.12 Ekrem Feka, mësime të Fizikës në SHFMU "A.Z.Çajupi" Vushtrri
 - 2.13 Samir Abazi, koordinator i cilësisë në SHMU 2 Vushtrri
 - 2.14 Aferdita Beka Aliu, mësime të Ed.qytetare në SHFMU "A.Z.Çajupi" Vushtrri
 - 2.15 Kumrije Smajli, mësime të klase në SHFMU "Abdyl Frashëri" Druar
2. Ekipi mbështetet nga projekti "Përkrahja për arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë- KosEd" i financuar nga zyra e BE-së për Arsim në Kosovë
3. Roli kryesor i ekipit është mbledhja e dëshmimeve që mbështesin dokumentimin e vetëvlerësimit dhe nxjerrjen e rekomandimeve në të mirë të përparimit dhe ngritjes së cilësisë në mësime të ndryshme dhe menaxhimin e institucioneve edukativo- arsimore të shkollave të komunës.
4. Ekipi do të jetë me anëtarë lëvizës dhe angazhimin fleksibil varësisht nga dinamika e planit të punës dhe do të raportojë çdo 3 muaj të zyra e kryetarit, DKA, SIA, MASHT.
5. Ekipi do të paguhet në bazë të ligjit të punës LIGJI Nr. 03/L-212 për punë shtesë.

Vendimi iu dërgohet:

- DKA-së
- Anëtarëve të ekipit
- Arkivit



Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës

Ferit Idrizi



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

02 Nr. / Br 1241/23

Nr. i fq. / Br. sf _____

Data: / Datum 27.10.2023

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Komuna Vushtrri

Zyra e Kryetarit të Komunës

Në mbështetje të nenit 13 dhe 58, nenin 62 paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L7-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe nenin 43 të Statutit të Komunës dhe duke u bazuar në kërkesën e z. Dardan Abazi, Kryetari i Komunës, nxjerr:

V E N D I M

1. **Z.Daradan Abazi**, në vendin e punës Drejtor i Drejtorisë për Arsim, lirohet nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë.
2. Punësimi i përfundon, më 27.10.2023 .

A r s y e t i m


Z.Dardan Abazi, në vendin e punës Drejtor i Drejtorisë për Arsim, ka kërkuar të lirohet nga vendi i punës për arsye personale, andaj i lirohet nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë për Arsim.
Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kopje: 1x1 Dardan Abazi;
1x1 - Thesarit;
1x1 Drejtorisë për Arsim
1x1 Njësisë së Personelit



Kryetari i Komunës


Ferit Idrizi



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

Bazuar në nenin 13, nenin 58 pika "f", nenin 62 paragr. 62.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008) dhe nenin 43 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **Z. Albanez Tahiraj**, nga Vushtrria, rruga "Haxhi Zeka" Hyrja B nr. 40 , komuna Vushtrri, emërohet Drejtor i Drejtorisë për Arsim, në Vushtrri.
2. I emëruari nga pika 1 e këtij vendimi duhet të paraqitet në vendin e punës me datën 30.10.2023.
3. Mandati i drejtorit është i njëjtë me mandatin e Kryetarit të Komunës i cili e ka emëruar, nëse ky mandat nuk i ndërpritet më herët.
4. Detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat në pozitën e emëruar do t'i ushroj në pajtim me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës, aktet tjera ligjore e nënligjore në fuqi, në Republikën e Kosovës si dhe urdhrave të Kryetarit të Komunës.
5. Drejtori i emëruar realizon pagë mujore në pajtim me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
6. Zyrtari është i obliguar që ta bëjë deklarinimin e pasurisë në AKK, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të pozitës.
7. Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Perit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrës së personelit
- Albanez Tahiraj
- Arkivit të Sekretarisë